



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:088692

Datë: 13.05.2022

Numri i dokumentit: 03006973

P.nr.6/2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues- gjyqtari Mentor Hajraj, anëtarët e trupit gjykues-gjyqtaret: Xhemajl Jusufi dhe Blerim Halimi, me zyrtaren ligjore Shqipe Sejdiu si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.A për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.98/2011, të dt. 28.12.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit të fundit gjyqësor më datën 15.04.2022, i cili ishte i mbyllur për publikun, për shkak të pandemisë Covid 19, në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit në PTH-Mitrovicë- Naim Beka dhe i akuzuari D.A, me dt. 19.04.2022, në mungesë të palëve publikisht ka shpallur, ndërsa më 13.05.2022, ka përpiluar me shkrim këtë;

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit; D.A, me nofkën “/”, nga i ati /, e ëma /, e gjinisë /, i lindur me /, në Mitrovicë, me vendbanim në adresën Rr.”/” nr./, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion elektrikist, i shkurorëzuar, ka të kryer shkollën e mesme teknike, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit /.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 30.07.2011, rreth orës 21:00 minuta, në Mitrovicë, në banesën e tij në rr.”/” nr./, pa autorizim ka shpërndarë dhe shitur substance narkotike, ashtu që nga i pandehuri nëpërmes FB(facebook) e dëmtuara J.K ka kërkuar që të blej një sasi substancash narkotike të llojit marihuanë dhe menjëherë që në kontaktin e parë në FB, i pandehuri i thotë që të marrë paratë e të shkoj në banesën e tij dhe e dëmtuara J. merr 20 euro dhe shkon tek i pandehuri i cili i shet të dëmtuarës J.K një qese me substancë narkotike me një çmim prej 10 euro dhe e dëmtuara pasi ka bërë xhoint (cigare marihuanë) duke e konsumuar të njëjtën policia e zë në flagrancë.

- **Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së.**

Andaj, gjykata ne mbështetje te nenit 3, 6, 15, 34, 38, 39, 64 dhe 73 KPK-së, lidhur me nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës i,

SHQIPTON

I.DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pasi aktgjykimi të merre formën e prerë dhe DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në kohën e caktuar nga gjykata, atëherë ky dënim në bazë të nenit 39 par.4 të KPK-së, do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, duke llogaritur 15 euro të gjobës për një ditë burgim.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe të arrestit shtëpiak prej datës 30.07.2011 deri më datën 06.03.2012, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Në bazë të nenit 60 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, gjykata shqipton:

- **DËNIM PLOTËSUES- MARRJA E SENDIT**

Konfiskohet narkotiku- një qese marihuanë e cila është sekuestruar nga Policia e Kosovës- Stacioni Policor Mitrovicë Veri, duke u bazuar edhe në nenin 229 par.5 të KPK-së,

Obligohet i akuzuari që të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën në lartësi prej njëzet (20) euro, në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën në lartësi tridhjetë (30) euro, dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën në lartësi pesëdhjetë (50) euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk kishte, andaj gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike nuk vendosi fare.

A r s y e t i m

- ***Aktakuza;***

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.nr.98/2011, të dt. 28.12.2011, kundër të akuzuarit D.A për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të KPK-së ndërsa kundër të akuzuarës J.K për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPK-së.

- ***Rrjedha e procedurës;***

Kjo gjykatë me datën 06.05.2019, sipas detyrës zyrtare në mbështetje me nenin 358 par.1 nën par.1.2 të KPP-së, ka nxjerrë aktvendim me të cilin është hudhur aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, me nr.PP.nr.98/2012 të dt.28.12.2011 dhe është pushuar procedura penale kundër të pandehurës J. K, për shkak të veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPK-së, për shkak të parashkrimit relativ të ndjekjes penale, ndërsa kundër të akuzuarit D.A ka vazhduar procedura penale.

Më datën 21.03.2022, gjykata fillimisht ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit D.A. Më pas kjo gjykatë pasi që në seancë ka mundur dëshmitarja e propozuar nga prokuroria e ka shtyrë seancën për datën 15.04.2022, ku edhe e ka mbajtur në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, i pandehuri dhe dëshmitarja L.J. Seanca e shqyrtimit gjyqësor kane qenë te mbyllur për publikun, kjo sipas vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të ruajtjes së shëndetit të palëve dhe të publikut, duke pasur parasysh gjendjen epidemiologjike me pandeminë Covid-19. Palët nuk kanë paraqitur vërejtje lidhur me këtë vendim. Ndërsa shpallja publike e aktgjykimit është bërë me dt.19.04.2022, ne mungesë të palëve.

Pretendimet e palëve-Fjala përfundimtare;

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: mbetem në tërësi pranë akuzës, meqenëse nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor, nga deklarata e dëshmitares L.J, nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve, nga raporti policor i dt.30.07.2021, nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës u provua se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Ka deklaruar po ashtu se nga deklarata e dëshmitares u provuan fakte me rëndësi dhe deklarata e saj është tërësisht e besueshme dhe përputhet edhe me provat- raportet policore dhe vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve, e njëjta ka deklaruar që nga vajza e saj i ish-in marrë 20 euro dhe me to kishte shkuar tek i akuzuari me qëllim që të blej substancë narkotike, ku 10 euro i ish-in kthyer nga policia e Kosovës, me cka provohet se vajza e saj- J.K me 10 euro tjera kishte blerë narkotik nga i pandehuri. Andaj i propozojmë gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, dhe ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I akuzuari në fjalë përfundimtare deklaroi se nuk e ndiej vetën fajtor dhe i propozoj gjykatës që të më liroj nga akuza.

Provat e administruara:

Meqenëse i akuzuari u deklarua i pafajshëm, gjykata kaloi në procedurën provuese dhe dëgjoi dëshmitaren L.J dhe i administroi provat e administruara nga prokuroria në aktakuzë siç janë: raporti i oficerit Milan Gemajlovic i dt.30.07.2011; vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt.30.07.2011; foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Procedimi i dëshmitareve:

Me propozimin prokurorisë ne aktakuze, gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.15.04.2022, ne cilësinë e dëshmitares është dëgjuar dëshmitarja L.J.

Dëshmitarja – L.J, është degjuar ne cilësinë e dëshmitarës ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur me datën e lartcekur, e njejta ne deshmine e saj nder te tjera ka deklaruar se ditën kritike e kam parë me sytë e mi se vajza ime J. kishte biseduar në facebook me të akzuarin D.A dhe e ka pyetur se a ki diçka për mua ndërsa i njejti i’u ishte përgjigjur se po kam bari (narkotikë), mirëpo mi sjell paratë, dhe kështu ajo nga unë kishte vjedh 20 euro. Unë gjatë tërë ditës nuk e kam ditur se ku është vajza ime, derisa në mbrëmje e hapa facebook- un dhe e pashë bashkëbisedimin që e ceka më lart dhe kështu menjëherë e kam telefonuar policinë dhe i kam informuar se vajzam ime- J. ka shkuar tek i akuzuari D.. Më pas policia e kanë ndalë vajzën time në stacion deri në mëngjes ndërsa mua mi kanë kthyer 10 euro. Dëshmitarja po ashtu deklaroi se vajza e saj ka qenë e moshës 24 vjeçare dhe po ashtu ka qenë përdoruese e substancave narkotike.

Administrimi i provave materiale:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 15.04.2022, janë administruara provat materiale si në vijim; raporti i oficerit Milan Gemajlovic i dt.30.07.2011; vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt.30.07.2011; foto-dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nga raporti i oficerit i datës 30.07.2011, vërtetohet se Policia e Kosovës- Stacioni Policor Mitrovicë Veri, ka pranuar një telefonat nga personi- dëshmitarja L.J, ku ka raportuar se vajza e saj J.K ka komunikuar me të akzuarin D.A përmes rrjetit social- facebook dhe ishin dakorduar që të takoheshin së bashku me qëllim që vajza e saj nga i akuzuari ta marrë narkotikun. Më pas policia kishin shkuar në vendin e ngjarjes, konkretisht tek shtëpia e të akzuarit D.A, dhe në brendi të shtëpisë kishte qenë edhe J.K tek e cila edhe kishin gjetur një qese me substancë narkotike ku edhe e kanë sekuestruar, si dhe të njëjtit kishin shkuar në stacion policor për të dhënë deklaratë në lidhje me rastin.

Nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve e dt.30.07.2011, vërtetohet se nga J.K është konfiskuar një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë.

Nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihet qesja me substancë narkotike të llojit marihuanë, shihet J.K dhe po ashtu shihet i akuzuari D.A.

Palët, prokurori i shtetit dhe i akuzuari në shqyrtim gjyqësor nuk patën propozime tjera për administrimin e ndonjë prove tjetër materiale.

Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari;

I akuzuari D.A, në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor të mbajtur me datën 15.04.2022, ndër të tjera ka deklaruar se është e vërtetë se J. atë ditë më ka thirre dhe më ka shkruar në facebook dhe më ka pyetur se a je në shtëpi, e njëjta natën vonë ka ardhur tek shtëpia ime dhe të njëjtën ditë para banesës sime J.K nga një person i panjohur ka marrë një qese dhe i ka dhënë të holla, kurse ai i ka kthyer paratë-kusur, ne nuk kemi biseduar asgjë rreth narkotikut, ndërsa më pas ka ardhur policia, fillimisht e kanë ftuar J. që të dal jashtë e më pastaj edhe mua dhe së bashku kemi shkuar në stacion policor ku në trupin e J. gjatë kontrollës e kanë gjetur narkotikun dhe paratë.

Pretendimet e të akuzuarit dhe vlerësimet e gjykatës lidhur me pretendimet e parashtruara në mbrojtjen e tij.

Pretendimi i të akuzuarit përkatësisht mohimi i tij për kryerjen e veprës penale dhe faktin se ai nuk dinë asgjë lidhur me këtë rast, gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe me qëllim të ikjes së përgjegjësisë penale, pasi që në bazë të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor e veçanërisht nga dëshmia e dëshmitares L.J u vërtetua se përmes rrjetit social, facebook, vajza e kësaj dëshmitare përkatësisht J. K ka kontaktuar me të akuzuarin D.A dhe nga i njëjti ka kërkuar narkotikë dhe se i akuzuari i është përgjigjur se kam bari (narkotikë) mirëpo mi sjell paratë. Një pretendim i tillë i të akuzuarit nuk gjen mbështetje as në provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor e nga të cilat u vërtetua se me datën 30.07.2011, Policia e Kosovës- Stacioni Policor Mitrovicë Veri, ka pranuar një telefonat nga personi- dëshmitarja L.J, ku ka raportuar se vajza e saj J.K ka komunikuar me të akuzuarin D.A përmes rrjetit social-facebook dhe ishin dakorduar që të takoheshin së bashku me qëllim që vajza e saj nga i akuzuari ta marrë narkotikun. Më pas policia kishin shkuar në vendin e ngjarjes, konkretisht tek shtëpia e të akuzuarit D.A, dhe në brendi të shtëpisë kishte qenë edhe J.K tek e cila edhe kishin gjetur një qese me substancë narkotike ku edhe e kanë sekuestruar, si dhe të njëjtit kishin shkuar në stacion policor për të dhënë deklaratë në lidhje me rastin, pastaj nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve e dt.30.07.2011, u vërtetua se nga J.K është konfiskuar një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë, si dhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës ku shihet qesja me substancë narkotike të llojit marihuanë, shihet J.K dhe po ashtu shihet i akuzuari D.A.

Vleresimi i provave;

Gjykata në vështrim të nenit 361 parag. 1 dhe 2 të KPP-së aktgjykimin për të akuzuarin, e bazoj në faktet dhe në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cilat prova i vlerësoi me ndërgjegje një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë erdhi në përfundim për fajësinë e të akuzuarit, e me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata u bazua në dëshminë e dëshmitarja L.J, e cila njëherit ishte nëna e J.K, e cila në shqyrtim gjyqësor deklaroi “se ditën kritike e kam parë me sytë e mi se vajza ime J. kishte biseduar në facebook me të akuzuarin D.A dhe e ka pyetur se a ka diçka për mua ndërsa i njëjti i’u ishte përgjigjur se po kam bari (narkotikë), mirëpo mi sjell paratë, dhe kështu ajo nga unë kishte vjedh 20 euro. Unë gjatë tërë ditës nuk e kam ditur se ku është vajza ime, derisa në mbrëmje e hapa facebook- un dhe e pashë bashkëbisedimin që e ceka më lart dhe kështu menjëherë e kam telefonuar policinë dhe i kam informuar se vajzam ime- J. ka shkuar tek i akuzuari D.. Më pas policia e kanë ndalë vajzën time në stacion deri në mëngjes ndërsa mua mi kanë kthyer 10 euro. Dëshmitarja po ashtu deklaroi se vajza e saj ka qenë e moshës 24 vjeçare dhe po ashtu ka qenë përdoruese e substancave narkotike”.

Përveç dëshmisë se dëshmitares me rastin e vendosjes gjykata u bazua edhe në administrimin e provave materiale të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor si: në raportin e oficerit i datës 30.07.2011, vërtetohet se Policia e Kosovës- Stacioni Policor Mitrovicë Veri, ka pranuar një telefonat nga personi- dëshmitarja L.J, ku ka raportuar se vajza e saj J.K ka komunikuar me të akuzuarin D.A përmes rrjetit social- facebook dhe ishin dakorduar që të takoheshin së bashku me qëllim që vajza e saj nga i akuzuari ta marrë narkotikun. Më pas policia kishin shkuar në vendin e ngjarjes, konkretisht tek shtëpia e të akuzuarit D.A, dhe në brendi të shtëpisë kishte qenë edhe J.K tek e cila edhe kishin gjetur një qese me substancë narkotike ku edhe e kanë sekuestruar, si dhe të njëjtit kishin shkuar në stacion policor për të dhënë deklaratë në lidhje me rastin, në vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve e dt.30.07.2011, vërtetohet se nga J.K është konfiskuar një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë, si dhe në foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës shihet qesja me substancë narkotike të llojit marihuanë, shihet J.K dhe po ashtu shihet i akuzuari D.A.

Provave të cekura si më lartë; dëshmisë se dëshmitares dhe provave materiale, kjo gjykate me rastin e vendosjes ua falë besimin e plotë ngase dëshmia e dëshmitares kishte në tersi mbështetje në provat materiale, e po ashtu provat materiale kishin ndërlidhje mes njëra tjetrës dhe në tersi

përputheshin me deklarimin e dëshmitares, andaj nga provat e cekura si me larte u vërtetua se ne veprimet e te akuzuarit përmbushën te gjitha elementet e veprës penale për te cilën ai akuzohet e po nga këto prova u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën ai akuzohet; Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 229 par.2 të KPK-së, për çka Gjykata të akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës për veprën e kryer penale dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjetjes e Gjykatës dhe faktet e vërtetuara nga Gjykata:

Duke u mbështetur në këto fakte dhe prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës në veprimet e të akuzuarit D.A përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 229 par.1 të KPK-së, ngase i njëjti me datën 30.07.2011, rreth orës 21:00 minuta, në Mitrovicë, në banesën e tij në rr.”” nr./, pa autorizim ka shpërndarë dhe shitur substance narkotike, ashtu që nga i pandehuri nëpërmes FB(facebook) e dëmtuara J.K ka kërkuar që të blej një sasi substancash narkotike të llojit marihuanë dhe menjëherë që në kontaktin e parë në FB, i pandehuri i thotë që të marrë paratë e të shkoj në banesën e tij dhe e dëmtuara J. merr 20 euro dhe shkon tek i pandehuri i cili i shet të dëmtuarës J.K një qese me substancë narkotike me një çmim prej 10 euro dhe e dëmtuara pasi ka bërë xhoint (cigare marihuanë) duke e konsumuar të njëjtën policia e zë në flagrancë, për çka gjykata të akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit;

Më rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, në rastin konkret si rrethanë lehtësuese gjeti rrethanat e tij sjelljet e tij korrekte në raport me gjykatën, pastaj faktin se i njëjti është i pa punë, gjendje jo të mirë ekonomike, fakti se ka nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar më shumë se dhjetë vite, ndërkaq rrethanë rënduese, Gjykata gjeti shkallën e përgjegjësisë penale te të akuzuarit, ngase Gjykata ka vërtetuar se ky i pandehur ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet e tij, se veprën penale e kishte kryer me dashje direkt.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarve iu shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale te të

akuzuarve dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Dënimi plotësues;

Vendimin mbi konfiskimin e substancës narkotike e një qese marihuanë e cila është sekuestruar nga Policia e Kosovës- Stacioni Policor Mitrovicë Veri, Gjykata e mori duke u bazuar nenin 60 par.2 lidhur me 1 të KPP-së dhe lidhur me depozitën e nenit 229 par. 5 të KPK-së, dhe sapo aktgjykimi të merre formën e prerë kjo substance narkotike do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

Shpenzimet e procedurës penale;

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2. 6 dhe nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 39 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike;

Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk pati, andaj për kërkesën pasurore-juridike gjykata nuk vendosi fare.

Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 365 të KPP-se, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.6/2012 dt.13.05.2022

Procesmbajtësja:

Shqipe Sejdiu

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Mentor Hajraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.